

Leximi i librave është, in primis, kënaqësi dhe kënaqësia nuk ka nevojë për detyrim. Ndaj dhe Fushatën për nxitje të Leximit e nisim me dëshirën për t'u sjellë në vëmendje brezave të rinj kënaqësinë e të lexuarit libra.

TAKOHEMI PËR NJË LIBËR me miq të vjetër e të rinj, në kafene, teatro, librari, biblioteka, shkolla e parqe për të rrëfyer historitë që na kanë formuar dhe frymëzuar, histori të trilluara që na ndriçojnë mendjen në realitetin e përditshëm.

Takim me Librin ku Ministria e Kulturës ju fton të merrni pjesë këtë vit me dëshirën për ta kthyer në një takim të përvitshëm.

Ta nxjerrim librin nga biblioteka dhe ta bëjmë një objekt të përditshmërisë: projekte leximi në rrjetet sociale, performanca mbi romanet në rrugë e parqe, minibiblioteka në hapësirat publike, lexime në shkolla, kafene, lulishte, bashkëbisedime për dhe me shkrimtarë e përkthyes do të jenë pjesëtarë të maratonës së Leximeve që nis në muajin Tetor. Ftojme që askush të mos mungojë në këtë takim të hareshëm me Dijen.

Entuziazmi me të cilin partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë iu përgjigjën Ftesës sonë, është dëshmi që Libri dhe Kultura janë hapësira pa kufi ku të gjithë jemi të mirëpritur.

Përshëndetje miqësore,
Mirela Kumbaro Furxhi
Ministre e Kulturës

Shqipëria do të përfshihet në Tetor në një Fushatë Kombëtare në nxitje të leximit. Me nismën e Ministrisë së Kulturës në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm do të realizohen këto projekte:

“Little Free Library në Shqipëri” - Ngri një bibliotekë të vogël për të gjithë, fito një bibliotekë të madhe për vete. Konkurs mbarëkombëtar që nxit përhapjen në Shqipëri të Minibibliotekave Kreative. Kush krijon minibibliotekën më kreative do të fitojë një pako me libra për pasurimin e bibliotekës së tij. Projekti do të nisë në Tetor dhe ceremonia e mbylljes së konkursit do të jetë në javën e parë të dhjetorit. Urojmë që sheshet, parqet, lulishtet, stacionet e autobusëve të zbukurohen me minibiblioteka ku gjithkush mund të marrë dhe të lërë një libër.

“Fondi për bibliotekat e Tiranës” – Bëhuni mik i bibliotekës suaj të lagjes. Për rigjallërimin e jetës së bibliotekave të lagjes, Ministria e Kulturës do të ndihmojë në pasurimin e Fondeve librore të gjashtë bibliotekave më aktive të qytetit të Tiranës. Mbi 100 tituj dhe 1200 libra do t'u falen këtyre bibliotekave gjatë muajit Tetor.

» në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës

“Albfotobook” – Libri, shoqëruesi më i mirë. Projekti synon vendosjen e Librit në qendër të vëmendjes, duke e nxjerrë atë nga biblioteka dhe duke e parë atë si objekt të përditshmërisë. Nisma në rrjetet sociale: Facebook, Twitter, me #Albfotobook dhe @Takohemipërnjëlibër synon fotografimin e librit dhe të personave që lexojnë në vende të ndryshme publike: autobusë, lulishte, rrugë, kafene, dyqane etj. Në këtë konkurs në ndihmë të fushatës së sensibilizimit gjithkush mund të bëhet protagonist si fotograf libri në #Albfotobook duke realizuar foto sa më interesante me librin si bashkëshoqërues të ditës. Projekti do të nisë në Tetor dhe ceremonia e mbylljes së konkursit do të jetë në javën e parë të dhjetorit.

“Unë lexoj”- Gjatë muajit tetor të gjitha shkollat e sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri do të organizojnë një orë leximi me të ftuar shkrimtarë dhe përkthyes të njohur nga zona e tyre.

» në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit

“Personazhet lexojnë” - Çdo fundjavë, të shtunë e të dielë, personazhet e librave ju presin nëpër parqe: Ana Karenina, Don Kishoti, Hamleti, Piter Pani, apo Doruntina do të lexojnë për ju pjesë nga libri që përfaqësojnë. Me aktorë në rolin e personazheve të veprave më të njohura të letërsisë botërore dhe shqiptare do të zhvillohen lexime publike në parqet dhe lulishtet e qytetit të Tiranës.

» në bashkëpunim me Agjencinë e Parqeve dhe Rekreacionit, Bashkia e Tiranës

Për më shumë informacion rreth këtyre nismave drejtoheni:

info@kultura.gov.al; Ervisa.Paloka@kultura.gov.al

Uarda.Llazi@kultura.gov.al

elsamyftaraj@hotmail.com

<http://www.albanianbooks.al>

www.shqiperialexon.simplesite.com

Fushatës Mbarëkombëtare të Leximit i bashkohen dhe:

- » Biblioteka Kombëtare; Teatri Kombëtar; Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”; Teatri i Kukullave; Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor; Drejtoritë Rajonale të Kulturës Kombëtare në të gjithë vendin.
- » Bashkitë e rretheve Shkodër, Lezhë, Pukë, Elbasan, Durrës, Korçë, Berat, Fier, Devoll, Skrapar, Vlorë, Gjirokastrë, Sarandë si dhe bibliotekat vendore dhe qendrore në rrethe.
- » Shtëpitë Botuese: Dituria, Toena, Albas.
- » Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë në UT.
- » Ambasadat e Huaja në Shqipëri: Ambasada Franceze, Ambasada Gjermane, Ambasada Italiane, Ambasada Ruse dhe Insituti Italian i Kulturës.

AMBASADA ITALIANE

07.10.2016 - Rai për gjuhën Italiane në Shqipëri.

Ora 10.30, Universiteti i Tiranës, Departamenti i Gjuhës Italiane. Organizuar nga Ambasada Italiane në Shqipëri

AMBASADA GJERMANE

12.10.2016 - Poetry-Slam. Prezantim me nxënësit e shkollës së mesme “Sami Frashëri”.

Ora 18.00, Salla e madhe, Ambasada Gjermane. Organizuar nga Ambasada Gjermane në Shqipëri dhe POETIKA në kuadër të Tetorit Gjerman.

19.10.2016 - Mbrëmje leximi

Ora 19.00, Teatri Metropolitan. Organizuar nga Ambasada Gjermane në Shqipëri dhe POETIKA në kuadër të Tetorit Gjerman.

21.10.2016 - Mbrëmje leximi.

Ora 19.00, Arka Center. Organizuar nga Ambasada Gjermane në Shqipëri dhe POETIKA në kuadër të Tetorit Gjerman.

AMBASADA RUSE

18.10.2016 - “Pushkini flet shqip”. Mbrëmje letrare. Ora 18.30, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”. Organizuar nga Ambasada Ruse në Shqipëri

AMBASADA FRANCEZE

25.10.2016 - Prezantimi i bibliotekës digjitale Culturethèque dhe lexime në frëngjisht. Ora 17.00, Salla “Auditorium”, Biblioteka Kombëtare. Organizuar nga Ambasada Franceze në Shqipëri dhe Aleanca Franceze

INSTITUTI ITALIAN I KULTURËS

25.10.2016 - Prezantimi në shqip i veprës «Kanali Musolini». Takim me autorin Antonio Pennacchi. Ora 11.00, Biblioteka e Institutit Italian të Kulturës. Organizuar nga Instituti Italian i Kulturës dhe Shtëpia Botuese DITURIA

26.10.2016 - Takim me autorin Antonio Pennacchi

Ora 11.00, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja. Organizuar nga Instituti Italian i Kulturës dhe Departamenti i Gjuhës Italiane.

29.09.2016

» Festivalit letrar “dadaEAST/dadaDAYS”. “DadaBUNK”. Lexime autoriale.

Ora 10.00, Bunkart

Organizuar nga shoqata POETIKA, mbështetur nga TRADUKI

» “Tirana lexon”. Maratonë leximi që vjen për herë të dytë në kuadër të TILF (Festivali Ndërkombëtar Letrar i Tiranës).

Ora 18.00, Qendra TEN, Tiranë

Organizuar nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë, mbështetur nga Ministria e Kulturës

» Festivalit letrar “dadaEAST/dadaDAYS”. Performancë e lirë me autorët e ftuar.

Ora 19.00, te Reja

Organizuar nga shoqata POETIKA, mbështetur nga TRADUKI

» “Kadare 2016”. Një koloni artistësh nga vendi dhe rajoni mblidhen në shtëpinë e Kadaresë për të realizuar vepra të frymëzuara nga pena e Kadaresë.

Ora 10.00-20.00, Shtëpia e Kadaresë, Gjirokastër

Organizuar nga Open Doors, mbështetur nga Ministria e Kulturës

30.09.2016

» “Tirana lexon”. Maratonë leximi që vjen për herë të dytë në kuadër të TILF (Festivali Ndërkombëtar Letrar i Tiranës).

Ora 18.00, Biblioteka Kombëtare, Tiranë

Organizuar nga Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë, mbështetur nga Ministria e Kulturës

» “Kadare 2016”. Një koloni artistësh nga vendi dhe rajoni mblidhen në shtëpinë e Kadaresë për të realizuar vepra të frymëzuara nga pena e Kadaresë.

Ora 10.00-20.00, Shtëpia e Kadaresë, Gjirokastër

Organizuar nga Open Doors, mbështetur nga Ministria e Kulturës

01.10.2016

» “Kadare 2016”. Një koloni artistësh nga vendi dhe rajoni mblidhen në shtëpinë e Kadaresë për të realizuar vepra të frymëzuara nga pena e Kadaresë.

Ora 10.00-20.00, Shtëpia e Kadaresë, Gjirokastër

Organizuar nga Open Doors, mbështetur nga Ministria e Kulturës

02.10.2016

» Ceremonia e hapjes së fushatës mbarëkombëtare të leximit.

Ora 12.00, Teatri Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”

Organizuar nga Ministria e Kulturës

- » “Personazhet lexojnë”. Organizimi i leximeve të hapura në lulishtet e qytetit të Tiranës nga aktorë në rolin e personazheve më të njohur të letërsisë botërore dhe shqiptare.

Ora 10.00, Parqet e Tiranës

Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

03.10.2016

- » Lexime të autorëve Zija Vukaj dhe Ermira Ymeraj në Shkollën e Mesme “Jordan Misja”.

Ora 10.30, Shkodër

Organizuar nga DRKK Shkodër

- » Orë e hapur në shkollën e mesme “Kristaq Capo” kushtuar Trashëgimisë Kulturore.

Ora 11.00, Berat

Organizuar nga DRKK Berat

- » “Një herë e një kohë...”. Biblioteka e Qytetit të Fierit mbledh të vegjlit e qytetit për një orë leximi.

Ora 11.00, Fier

Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

04.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Muço Delo”.

Ora 12.00, Aulonë, Vlorë

Organizuar nga DRKK Vlorë

- » Lexime nga romani “Kronikë në gur”, me praninë e turistëve gjermanë.

Ora 14.00, Shtëpia e Skëndulatëve, Gjirokastër

05.10.2016

- » Lexime me shkrimtaren e ftuar Mimoza Erebara me nxënësit e shkollës “Gjergj Kastrioti”.

Ora 11.00, Torra Veneziane, Durrës

Organizuar nga DRKK Durrës

- » Lexime nga romani “Kronikë në gur”, me praninë e turistëve gjermanë.

Ora 14.00, Shtëpia e Skëndulatëve, Gjirokastër

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntë vjeçare “Thoma Turtulli”.

Ora 11.00, Korçë

Organizuar nga Bashkia Korçë

06.10.2016

- » “Takim me shkrimtarë italianë”, në bashkëpunim me Institutin Italian të Kulturës.

Ora 14.00, Berat

Organizuar nga DRKK Berat

- » Lexime në shkollat e Vlorës me praninë e shkrimtarëve vlonjatë.

Ora 11.00, Vlorë

Organizuar nga Biblioteka Publike e Vlorës “Shevqet Musaraj”

07.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës së mesme të Vlorës.

Ora 11.00, Parku Arkeologjik Amantia, Vlorë

Organizuar nga DRKK Vlorë

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Ndre Mjeda”.

Ora 11.00, Shkodër

Organizuar nga DRKK Shkodër

- » Lexime me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare të Fierit.

Ora 11.00, Fier

Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

08.10.2016

- » Festivali i poezisë “Motive Migjeniane”.

Ora 11.00, Pukë

Organizuar nga Emal Sh.p.k. & Miqtë e Librit “Lead Albania”

09.10.2016

- » “Personazhet lexojnë”. Organizimi i leximeve të hapura në lulishtet e qytetit të Tiranës nga aktorë në rolin e personazheve më të njohur të letërsisë botërore dhe shqiptare.

Ora 10.00, Parqet e Tiranës

Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

10.10.2016

- » Ekspozitë në Bibliotekën Kombëtare. Ligjëratë me temë “Agolli dhe Migjeni” nga Akademiku Shaban Sinani.

Ora 11.00, Biblioteka Kombëtare

Organizuar nga Biblioteka Kombëtare

- » Bashkëbisedim me fëmijët me praninë e shkrimtarëve Astrit Bishqemi dhe Beatrice Ballici.

Ora 10.00 , Qendra Riemar, Elbasan

Organizuar nga Biblioteka Publike e Elbasanit “Qemal Baholli”

- » Lexime me shkrimtaren e ftuar Alma Begaj me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Vinçenc Prendushi”.

Ora 11.00 , Amfiteatër, Durrës

Organizuar nga DRKK Durrës

- » “Një herë e një kohë...”. Biblioteka e Qytetit të Fierit mbledh të vegjlit e qytetit për një orë leximi.

Ora 11.00, Fier

Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

11.10.2016

- » Ekranizim i romanit “Njeriu me top”.

Ora 11.00 , AQSHF

Organizuar nga AQSHF

- » Lexime në shkollën e mesme “At Pjetër Meshkalla”.

Ora 12.00, Shkodër

Organizuar nga DRKK Shkodër

12.10.2016

- » Lexime në bibliotekën e Medresesë “Haxhi Sheh Sharmia”.

Ora 10.00, Shkodër

Organizuar nga DRKK Shkodër

- » Ekranizim i romanit “Apasionata”.

Ora 11.00, AQSHF

Organizuar nga AQSHF

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare të Kaninës.

Ora 11.00, Kalaja e Kaninës, Vlorë

Organizuar nga DRKK Vlorë

- » Promovimi i librit enciklopedik “Gjerdani i artë i brezave të këngës dhe muzikës të qytetit tim”, i autorit Stavri Bobo.

Ora 12.00, Berat

Organizuar nga DRKK Berat

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Thoma Turtulli”.

Ora 11.00, Korçë

Organizuar nga Bashkia Korçë

13.10.2016

- » Ceremonia e kremtimit të 85-vjetorit të ditëlindjes së Dritëro Agollit.
Ora 19.00, Teatri Kombëtar
Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Teatri Kombëtar
- » Lexime në shkollën nëntëvjeçare “Ismail Qemali”.
Ora 11.00, Shkodër
Organizuar nga DRKK Shkodër
- » Ekranizim i romanit “I teti në Bronx”.
Ora 11.00, AQSHF
Organizuar nga AQSHF
- » “Krijimtaria më e mirë”. Konkurs letrar midis nxënësve të shkollave nëntëvjeçare të Korçës.
Ora 12.00, Parku Rinia, Korçë
Organizuar nga Bashkia Korçë
- » Lexime me nxënësit e shkollave të Vlorës.
Ora 11.00, Vlorë
Organizuar nga Bashkia Vlorë
- » Ekspozitë me veprat e Dritëro Agollit.
Ora 11.00, Biblioteka e Fierit, Fier
Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

14.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës së mesme të Orikumit.
Ora 11.00, Kalaja e Orikumit, Vlorë
Organizuar nga DRKK Vlorë
- » Lexime në shkollën e mesme “28 Nëntori”.
Ora 11.00, Shkodër
Organizuar nga DRKK Shkodër
- » “Dita e Lasgush Poradecit dhe Mitrush Kutelit”. Takim me nxënës dhe profesorë.
Ora 11.00, Libraria “Shtëpia e Miqve”, Pogradec
Organizuar nga DRKK Korçë
- » “Libri si përcjellës i edukimit ndërkulturor dhe kulturës Rome”.
Ora 16.00, Qendra Ten
Organizuar nga IRCA
- » Lexime me shkrimtarin e ftuar Ilir Paja me nxënësit e shkollës së mesme “Naim Frashëri”.
Ora 11.00, Rotondo, Durrës
Organizuar nga DRKK Durrës
- » Lexim i hapur me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare të Fierit.
Ora 11.00, Fier
Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit
- » “SABBAT”. Ceremonia përmbyllëse e workshopeve rikrijuese.
Ora 18.00, Salla “Tefta Tashko”, Ministria e Kulturës
Organizuar nga Luljeta Lleshanaku, mbështetur nga Ministria e Kulturës
- » “Mbrëmje poetike Agolliane”. Takimi i përmuajshëm i rrethit letrar Book Station.
Ora 19.00, Tea Room
Organizuar nga Book Station

15.10.2016

- » Lexim i hapur me nxënësit e shkollave të mesme të Elbasanit.
Ora 11.00, Biblioteka Publike “Qemal Baholli”, Elbasan
Organizuar nga Biblioteka Publike e Elbasanit
- » “Më fto për një libër”.
Ora 12.00, Amfiteatër, Durrës

Organizuar nga Aktivizmi Rinor Durrës

- » “Dita e letërsisë së huaj”. Leximi i poezive të huaja.

Ora 12.00, Libraria “Shtëpia e Miqve”, Pogradec

Organizuar nga DRKK Korçë

16.10.2016

- » “Personazhet lexojnë”. Organizimi i leximeve të hapura në lulishtet e qytetit të Tiranës nga aktorë në rolin e personazheve më të njohur të letërsisë botërore dhe shqiptare.

Ora 10.00, Parqet e Tiranës

Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

- » “Dita e poetëve të rinj të qytetit të Pogradecit”. Promovimi i autorëve dhe librave të rinj.

Ora 13.00, Libraria “Shtëpia e Miqve”, Pogradec

Organizuar nga DRKK Korçë

17.10.2016

- » Hapja e fazës së parë të projektit “Readers of the future”.

Ora 11.00, Friend’s Book House

Organizuar nga Shtëpia Botuese DITURIA, mbështetur nga EUROPA KREATIVE

- » “Festivali letrar për të rinj”-Lexime.

Ora 11.00, Parku Rinia

Organizuar nga Shtëpia Botuese TOENA, mbështetur nga Ministria e Kulturës

- » “Një herë e një kohë...”- Biblioteka e Qytetit të Fierit mbledh të vegjlit e qytetit për një orë leximi.

Ora 11.00, Fier

Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

- » “Dita e leximit me fotografi”. Interpretimi i poezive të Lasgush Poradecit, të përcjella nëpërmjet fotografive të vjetra të qytetit.

Ora 12.00, Fototeka “Misto Cici”, Pogradec

Organizuar nga DRKK Korçë

18.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës së mesme të Finiqit.

Ora 11.00, Parku Arkeologjik Finiq, Vlorë

Organizuar nga DRKK Vlorë

- » Takim me shkrimtaren Merita Thartori me nxënësit shkollës “19 nëntori”.

Ora 11.00, Mozaiku te Gora, Durrës

Organizuar nga DRKK Durrës

19.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës së mesme “Oso Kuka”.

Ora 11.30, Biblioteka Publike “Marin Barleti”, Shkodër

Organizuar nga Biblioteka Publike “Marin Barleti”, Shkodër

- » “Orë leximi me përralla të zgjedhura”.

Ora 11.30, Kopështi i fëmijëve “10 korriku”, Berat

Organizuar nga DRKK Berat

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Thoma Turtulli”.

Ora 12.00, Biblioteka Publike “Thimi Mitko”, Korçë

Organizuar nga Bashkia Korçë

- » Ndikimi i revistave studimore dhe letrare në procesin e leximit. Prezantimi i numrit të katërt të revistës “Pasqyra e t’rrëfymit”.

Ora 11.00, Friend’s Book House

Organizuar nga Qendra e Studimeve Letrare “Pjetër Budi”.

20.10.2016

- » Aktivitet me shkrimtarët Xhahid Bushati, Viktor Canosinaj, Alfred Çapaliku dhe Adil Zekja në Shtëpinë e Fëmijës Shkodër.
Ora 17.00, Shtëpia e Fëmijës Shkodër
Organizuar nga DRKK Shkodër
- » Lexime me shkrimtarin Salvator Gjeçi në shkollën nëntëvjeçare “Gjergj Fishta”.
Ora 12.00, Lezhë
Organizuar nga DRKK Shkodër
- » “Stimulimi i leximeve në vende publike”.
Ora 11.00, Vlorë
Organizuar nga Biblioteka Publike e Vlorës “Shevqet Musaraj”

21.10.2016

- » “GeGpoezi”. Lexime nga autorë të poezisë geqe.
Ora 16.00, Qendra Rinore “ATA”, Kamëz
Organizuar nga Shoqata “ATA”
- » “Kush dhuron një libër, dhuron një thesar”. Thirrje e hapur ndaj nxënësve për pasurimin e bibliotekave.
Ora 10.00, Korçë
Organizuar nga Bashkia Korçë
- » Lexime me nxënësit e shkollës së mesme të Himarës.
Ora 11.00, Himarë, Vlorë
Organizuar nga DRKK Vlorë
- » “Poezia dhe muzika”. Lexime me nxënësit e shkollës së mesme artistike “Ajet Xhindole”.
Ora 12.00, Berat
Organizuar nga DRKK Berat
- » Lexime me shkrimtarin e ftuar Agim Bajramaj me nxënësit e shkollës “Marie Kaculini”.
Ora 15.00, Termat Romake, Durrës
Organizuar nga DRKK Durrës
- » Lexim i hapur me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare të qytetit të Fierit.
Ora 12.00, Biblioteka Publike e Fierit
Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

23.10.2016

- » “Personazhet lexojnë”. Organizimi i leximeve të hapura në lulishtet e qytetit të Tiranës nga aktorë në rolin e personazheve më të njohur të letërsisë botërore dhe shqiptare.
Ora 10.00, Parqet e Tiranës
Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit

24.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare të Spilesë.
Ora 10.00, Spile, Vlorë
Organizuar nga DRKK Vlorë
- » “Një herë e një kohë...”. Biblioteka e Qytetit të Fierit mbledh të vegjlit e qytetit për një orë leximi.
Ora 11.00, Fier
Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit

25.10.2016

- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “1 maji”.
Ora 10.00, Berat
Organizuar nga DRKK Berat
- » Prezantimi i librit “Kanali Musolini”.
Ora 11.00, Instituti Italian i Kulturës
Organizuar nga Instituti Italian i Kulturës dhe Shtëpia Botuese DITURIA

26.10.2016

- » Lexime me shkrimtaren Alisa Velaj me nxënësit e shkollës së mesme “Leonik Tomeo”.
Ora 10.00, Muzeu Arkeologjik Durrës
Organizuar nga DRKK Durrës
- » Lexime me shkrimtaren e ftuar Ledi Myshketa me nxënësit e shkollës së mesme artistike “Jan Kukuzeli”.
Ora 12.00, Hamami Mesjetar i Qytetit të Durrësit
Organizuar nga DRKK Durrës
- » Lexime me nxënësit e shkollës nëntëvjeçare “Thoma Turtulli”.
Ora 11.00, Biblioteka Publike “Thimi Mitko”, Korçë
Organizuar nga Bashkia Korçë
- » Takim me shkrimtarin Antonio Pennacchi.
Ora 11.00, Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Tiranë
Organizuar nga Shtëpia Botuese DITURIA, Instituti Italian i Kulturës dhe Departamenti i Italianistikës, Universiteti i Tiranës.

27.10.2016

- » “Gjueti thesari”. Lojë argëtuese në kërkim të librave.
Ora 09.00, Biblioteka Publike “Marin Barleti”, Shkodër
Organizuar nga Shoqata NVS (Nisma Vullnetare Studentore, Shkodër)
- » Lexime me nxënësit e shkollave “Ismail Qemali” dhe “Jani Minga”.
Ora 11.00, Ambientet e DRKK Vlorë
Organizuar nga DRKK Vlorë
- » Lexime me/për gjyshër.
Ora 10.00, Biblioteka Publike “Shevqet Musaraj”, Vlorë
Organizuar nga Biblioteka Publike e Vlorës “Shevqet Musaraj”

28.10.2016

- » Organizimi i një minibiblioteke në ambientet e shkollës nëntëvjeçare “Zihni Toska”.
Ora 09.00, Berat
Organizuar nga DRKK Berat
- » Lexim i hapur me nxënësit e shkollave nëntëvjeçare të Fierit.
Ora 11.00, Biblioteka Publike e Fierit
Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit
- » Aktiviteti përmbyllës i muajit të librit në Shkodër.
Ora 10.00, Teatri “Migjeni”, Shkodër
Organizuar nga DRKK Shkodër

29.10.2016

- » “Ankandi i librit tim”. Shkëmbim librash mes të rinjve.
Ora 10.00, Tiranë
Organizuar nga Shoqata “Ardhmëria”

30.10.2016

- » “Personazhet lexojnë”. Organizimi i leximeve të hapura në lulishtet e qytetit të Tiranës nga aktorë në rolin e personazheve më të njohur të letërsisë botërore dhe shqiptare.
Ora 10.00, Parqet e Tiranës
Organizuar nga Ministria e Kulturës dhe Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit
- » Promovimi i autorëve dhe përkthyesve më të mirë të Elbasanit.
Ora 11.00, Biblioteka Publike “Qemal Baholli”, Elbasan
Organizuar nga Biblioteka Publike e Elbasanit “Qemal Baholli”

31.10.2016

- » “Një herë e një kohë...”. Biblioteka e Qytetit të Fierit mbledh të vegjlit e qytetit për një orë leximi.

Ora 11.00, Fier

Organizuar nga Biblioteka Publike e Fierit